



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 103/ 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së pankartave në afërsi të Qendrës së Votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuara ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 30.04.2010, nga subjekti politik PDK me te cilën pretendohet se me datën 29.04.2012, në ditën e zgjedhjeve për kryetar komune të Ferizajt, subjekti politik AAK në vendvotimin e fshatit Pleshinë e Epërme në shkollën fillore “5 Dëshmorët e Kombit” në një afërsi prej 35 metra ka vendosur pllakata dhe postera të subjektit dhe kandidatit për kryetar të komunës, duke e shkelur Rregullën zgjedhore dhe Kodin e Mirësjelljes përkatësisht nenin 36.1 pika a)

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 01.05.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 02.05.2012, në ora 14:00. PZAP, nuk mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK, sipas afatit të caktuar.

PZAP-i, në bazë të nenit 4 paragrafi 2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 30.04.2012, ka kërkuar nga subjekti politik PDK përmirësimin e ankesës së parashtruar nga pala ankuese. Subjekti politik PDK, brenda kohës së përcaktuar nga PZAP-i, ka bërë përmirësimin e ankesës Anr.103/2012 datë 30.04.2012.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi nga vendi i supozuar i ngarjes.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkakut se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për tu vërtetuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar në ankesë, pasi që nga fotot e ofruara si dëshmi që gjenden në shkresat e lëndës nuk shihet qartë se ku janë të vendosura këto pankarta, si dhe nuk identifikohet se a kanë qenë në afërsi të Qendrës së Votimit apo diku tjetër, si dhe nuk mund të identifikohet se cila ka qenë distanca në mes tyre. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë dhe në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 103/2012 më datën 03.05.2012.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**

